قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 12-352/07-0025414/26
Data Data 07.07.2026

KOMUNA E SKENDERAJT
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm
Direkcija za Ekonomski Razvoj Preduzetništvo Inovacije i Turizam
Directorate for Economic Development Entrepreneurship Innovation and Tourism

DATË/A:	07.06.2026
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm; Drejtoreshë: znj. Besarta Meha Ademi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për aplikim

KOMUNA E SKENDERAJT DHE ORGANIZATA QATAR CHARITY

THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Skenderajt dhe Organizata Qatar Charity , bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 12-352/07.0024100/26, të datës 01.07.2026, të nënshkruar në Komunën e Skenderajt, do të zbatojnë projektin për hapjen e puseve me gypa të ngushtë në territore gurore, të dedikuar për familjet në nevojë me gjendje të rënduar ekonomike. Projekti ka për qëllim përmirësimin e qasjes në ujë të pijshëm dhe ngritjen e mirëqenies së familjeve në komunën e Skenderajt.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret si:

- ✓ Të jetë banorë i Komunës së Skenderajt;
- ✓ Të mos posedojnë pus (bunar) funksional dhe të mos kenë furnizim të mjaftueshëm me ujë për nevojat e familjes;
- ✓ Vendi i propozuar për hapjen e pusit duhet të jetë në zonë gurore, ku teknologjia e puseve me gyp të ngushtë është e zbatueshme, kategoria me thellësi 75m dhe 100m;

Projektet do të dedikohen për:

- Familjet me numër më të madh të anëtarëve;
- Familjet me asistencë sociale;
- Familjet me kushte të dobëta ekonomike;
- Familjet me fëmijë jetim;

- Familjet me anëtarë që vuajnë nga sëmundje të rënda kronike apo invaliditet;

Dokumentet obligative për aplikim:

- Kërkesën e plotësuar për aplikim me emrin e rrugës dhe numrin e shtëpisë;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata Themelore, që dëshmon se aplikuesi nuk është nën hetime;
- Certifikatën e Bashkësisë Familjare;
- Konfirmimin e të ardhurave (pasqyra bankare për periudhën kohore 6 muaj të fundit dhe/ose dokument zyrtar nga ana e institucioneve të vendit i cili vërteton se personi në fjalë është i pa-punë;

Dokumentet shtesë për aplikim:

- Dokumente zyrtare kopje (*familjet me anëtarë që kanë sëmundje të rënda kronike apo ato me invaliditet*);
- Kartelën e ndihmës sociale kopje (*familjet me asistencë sociale*);

Marrja e aplikacioneve si dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet përmes arkivit në sportelin nr. 13 në komunën e Skenderajt, prej datës 07.07.2026 deri me datën 27.07.2026 nga ora 09:00-15;00h.

Vëmendje: *Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në një kopje dhe brenda periudhës së aplikimit, pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.*